



DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZGJERIM

UDHËZIME MBI  
MBËSHTETJEN E BE-SË  
PËR LIRINË E MEDIAVE DHE  
INTEGRITETIN E MEDIAVE  
NË VENDET E ZGJERIMIT  
2014-2020



Bashkimi Europian

# 1. LIRIA E TË SHPREHURIT DHE LIRIA E MEDIAVE



Liria e të shprehurit është e drejtë fundamentale e mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut, dhe formon një pjesë përbërëse të funksionimit të një demokracie pluraliste. Kjo e drejtë u përket vlerave mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian (siç referohet në Nenin 2, në Traktatin e Bashkimit Evropian). Respektimi i këtyre vlerave dhe angazhimi për t'i promovuar ato, janë kriteret kryesore për të vlerësuar aspiratat e një vendi që don të anëtarësohet në Union (Neni 49, ibid.). Që andej e tutje, liria e të shprehurit është një pjesë e brendshme e kriterëve politike të Kopenhagës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Duhet të theksohet se duke qenë e drejtë themelore e njeriut, liria e të shprehurit dhe liria e mediave shpesh është parakusht për implementimin e të drejtave dhe lirive të tjera. Të privuar nga mediat e lira, qytetarëve u është mohuar e drejta e informimit të balancuar, faktik dhe të besueshëm, pa iu ekspozuar paragjykimeve dhe propagandës, e cila është duke e dekurajuar demokracinë dhe efikasitetin e institucioneve. Konteksti pluralist i mediave shërben për të zbuluar natyrën e ndërlikuar të shoqërisë dhe promovon dialogun dhe tolerancën. Vëzhgimi kritik i mediave ndaj proceseve politike garanton transparencën e tyre dhe garanton që qeveritë t'u përmbahen politikave të parashikueshme – pa interesa të ngushta të grupeve të tensionuara. Në tërësi, kjo përmirëson qeverisjen në një vend të caktuar të anëtarësimit dhe në këtë mënyrë krijon besimin në Shtetet e ardhshme Anëtare të Bashkimit Evropian.

## 2. AGJENDA E ZGJERIMIT PËR LIRINË E MEDIAVE DHE INTEGRITETIN E MEDIAVE

Mediat e lira janë parakusht kryesor për lirinë e të shprehurit. Meqenëse mediat dhe tregjet e tyre janë kryesisht me shtrirje nacionale, ka shumë pak legjislacion në nivel të BE-së që e rregullon këtë sferë<sup>1</sup>. Megjithatë, në kontekst të politikës evropiane të Zgjerimit, Komisioni Evropian është i obliguar që sipas kriterëve politike të Kopenhagës të bëjë vlerësimin e plotë dhe të konkludojë nëse ekziston respekt real dhe angazhim i vërtetë në promovimin e lirisë së shprehjes në vendin e caktuar që aspirojnë anëtarësimin. Vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe mangësitë e identifikuar duhet të shqyrtohen dhe të korrigojnë nga vendet e zgjerimit madje edhe nëse nuk ekziston rregullativë e BE-së që duhet respektuar dhe zbatuar. Vlerësimet vjetore të gjendjes që kanë të bëjë me lirinë e të shprehurit dhe mediave në vendet e veçanta të zgjerimit, gjenden në Raportet e rregullta të Progresit.

Para disa vitesh, kriza ekonomike goditi rëndë vendet e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor. Kjo zbehu dukshëm pozitën financiare<sup>2</sup> të mediave dhe veçoi si katalizator për të sjellë në sipërfaqe mekanizma të ndryshëm që përdoren për të ushtruar presion formal dhe joformal kundër mediave kritikuese nga qarqet politike dhe afariste. Përkeqësimi i gjendjes alarmante, avancoi lirinë e të shprehurit në një nga prioritetet kryesore në kontekst të zgjerimit dhe si rrjedhojë, kjo u reflektua në dokumentet vjetore të Strategjisë së Zgjerimit<sup>3</sup>.

Me qëllim të kuptimit të plotë të natyrës sistematike të sfidave me të cilat përballen liria e të shprehurit në zonën e Zgjerimit dhe hartimit të përgjigjeve adekuate të politikave të saj, Komisioni organizoi dy konferenca Fol me zë të lartë! (2011 dhe 2013) ku përfshihej pjesëmarrës nga komuniteti i mediave, organizatat e tyre në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, si dhe vendim-marrësit e këtyre vendeve. Këto dy evenimente dhe konkluzat pasuese<sup>4</sup> janë bërë pika të rëndësishme referimi në trajtimin e çështjeve të lirisë dhe integritetit të së mediave në kontekst të politikës së zgjerimit.

Në aspektin politik, u vendos që të shfrytëzohet potenciali i plotë i negociatave të anëtarësimin, në mënyrë që të arrihet progress në çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit. Veçanërisht Kapitulli 23 (por edhe Kapitulli 10 dhe të tjerë, në qoftë se kanë të bëjnë me temat që kanë ndikim në sektorin e mediave) dhe plani përkatës i veprimin, duhet të përfshijnë këtë fushë plotësisht. (Për vendet që nuk i kanë filluar akoma negociatat e anëtarësimin, duhet të përdoren format e caktuara të dialogut politik të nivelit të lartë, në mënyrë që të shqyrtohen tema shqetësuese që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit dhe të gjinden mjetet e duhura).

<sup>1</sup> Direktiva e Shërbimeve Mediatike Audiovizuale

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2010:095:0001:0024:en:PDF>

Komunikatë nga Komisioni mbi aplikimin e rregullave të Ndhmës Shtetërore për transmetimin e shërbimit publik (Tekst me relevancë EEA)

[http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52009XC1027\(01\):EN:NOT](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52009XC1027(01):EN:NOT)

<sup>2</sup> Ky sektor ishte në mesin e atyre që pësuan më së shumti: sipas vlerësimeve të ndryshme rënia e reklamave komerciale ishte rreth 40%

<sup>3</sup> Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/strategy\\_paper\\_2013\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf)

<sup>4</sup> [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/speak\\_up\\_2/20130801\\_speakup-conclusions.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/speak_up_2/20130801_speakup-conclusions.pdf)

Ekziston nevojë e qartë për një angazhim më të gjatë për të arritur rezultate të qëndrueshme. Për këtë qëllim, Komisioni është angazhuar që të zhvillojë një qasje për ndihmë afatgjate (2014-2020) e cila do të mbështetet me kornizën e rezultateve për të përkrahur arritjen e qëllimeve politike në fushën e lirisë të shprehjes dhe integritetit të mediave.

Kjo qasje strategjike gjithashtu do të ndiqet me ndihmë financiare dhe teknike, me anë të Instrumentit për Ndhmë Para-Anëtarësuese, i cili do të synojë tre fusha gjithëpërfshirëse: mjedisi i favorshëm për shprehje dhe media të lira; përforcimi i organizatave të gazetarëve dhe organizatave profesionale të mediave si nxitësit kryesorë të ndryshimit të nevojshëm; ndihma për mediat për të përmirësuar qeverisjen e tyre të brendshme, duke i bërë në këtë mënyrë më fleksibile kundër shtypjeve të jashtme dhe duke kthyer besimin e audiencës.

### 2.1 Mjedisi i favorshëm për lirinë e shprehjes dhe media të lira

Vënien në përdorim të kushteve ligjore, institucionale dhe politike për krijimin e një mjedisi të favorshëm për lirinë e të shprehurit është përgjegjësi e pushtetit politik dhe legjislativ në një vend të caktuar të anëtarësimin. Në shumicën prej tyre, Parlamenteve u jepet roli i vulosjes së vendimeve qeveritare.

Njëkohësisht, deputetët e parlamenteve zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në këtë mënyrë mbajnë përgjegjësinë përfundimtare për lirinë e të shprehurit në vendin e tyre. Prandaj, Komisioni do të inkurajojë dhe do t' u ndihmojë të plotësojnë këtë përgjegjësi; për më tepër, sepse ajo është një nga potencialet më të pashfrytëzuara deri më tani në përshejtimin e progresit të prituri lidhur me këto çështje të vështira. Kriza ekonomike është faktor i rëndësishëm përgjegjës për rënien dramatike të standardeve profesionale dhe etike në gazetari. Kjo krizë ka zgjuar klientelizmin dhe politizimin e mediave, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e produktit përfundimtar. Lidhur me këtë sfond dhe në mungesë të vetë-rregullativës efektive profesionale në këtë sektor, për politikanët është e lehtë të përdorin fuqinë shtetërore – gjyqësorin – kundër gazetarisë kritikuese. Edhe pse numri më i madh i vendeve të zgjerimit kanë dekriminalizuar ligjet e shpifjes, zhvillimi i praktikave të duhura gjyqësore (në bazë të Nenit 10, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe praksës gjyqësore të ECtHR-së) në rastet që përfshijnë gazetarët, do të jetë detyrë sfiduese për një kohë të gjatë në të ardhmen.

Sa për zbatimin dhe vënien në fuqi të ligjeve që ndikojnë mediat në mënyrë direkte apo indirekte, ajo duhet të jetë konsekuente dhe pa hijen e "drejtësisë selektive". Këtu, pavarësia dhe politike dhe profesionalizmi i autoriteteve rregullatore luajnë rol vendimtar. Garancitë për këtë duhet të jenë të parapara me ligj, por krijimi i një regjistri është po aq i rëndësishëm.

Mediat e Shërbimit Publik (MSHP), ndryshe nga mediat e tjera komerciale, themelohen me ligj apo me akte të ngjashme. Pra, formalisht, por edhe sipas funksionit të tyre, MSHP-të i përkasin mjedisit të favorshëm për lirinë e të shprehurit. Përveç kësaj, ato përdorin paratë publike për të financuar aktivitetet e tyre. Në këtë drejtim, MSHP-të nuk duhet të ndërhyjnë në transmetimet komerciale (siç përmendet në legjislacionin e BE-së<sup>5</sup>), dhe, në të njëjtën kohë, duhet të sigurojnë pluralitetin e vërtetë të përmbajtjes (siç është përcaktuar saktësisht me ligj – fushëveprimi i shërbimit publik) – gjë që mediat komerciale nuk janë të detyruara ta bëjnë. Statusi aktual i Transmetuesve të Shërbimit Publik në rajon është qartë në kundërshtim me atë që është këshilluar në legjislacionin e BE-së, pasi që qeveritë ushtrojnë kontroll politik dhe financiar mbi ato. Duhet të zhvillohen dhe futen në përdorim strategjitë gjithëpërfshirëse të reformave – të rrënjësura në fushëveprimin e shërbimit publik, siç është pasqyruar në ligj dhe të sigurohet autonomia e financimit për transmetimin publik.

<sup>5</sup> Komunikatë e Komisionit mbi zbatimin e rregullave shtetërore për ndihmë në transmetimin e shërbimit publik (Tekst me relevancë EEA);

[http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52009XC1027\(01\):EN:NOT](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52009XC1027(01):EN:NOT)

## 2.2. Marrja e përgjegjësisë nga mediat për qeverisje dhe produksion të përmirësuar të brendshëm

Përkeqësimi i kushteve ekonomike formojnë një tundim për shumë media që të devojnë nga praktikatat e rregullta të biznesit. Ato shpesh futen në "zonën gri" për sa u përket tatimeve apo ligjeve të punës. Ekziston një rrezik real i rrezikimit të politikave redaktuese dhe etikës profesionale për hir të marrjes së fondeve publike ose komerciale. Si rezultat i kësaj, zvogëlohet besimi në mediat tradicionale.

Përmbysja e kësaj tendence është një sfidë serioze për redaktorët dhe pronarët e mediave. Para së gjithash, kjo do të thotë respektim i kodeve editoriale dhe etike të definuara qartë (dhe publikisht). Duhet të ekzistojnë mekanizma efektivë për të trajtuar me sinqeritet dhe në mënyrë transparente ankesat e lexuesve/ shikuesve. Të gjithë të punësuarit (duke përfshirë këtu edhe ata që punojnë me gjysmë orari të punës dhe ata të pavarur) në një medium duhet të kenë kontrata të duhura pune, gjë që do të vërtetonte se nuk ka vend për autocensurë të shkaktuar nga marrëdhëniet e dobëta të punës. Duhet të jenë të pranishme mundësitë për zhvillimin e aftësive profesionale të gazetarëve; sidomos në pikëpamjen e mësimin për të vepruar në mjedisin e ndryshueshëm të medias. Në përgjithësi, këto iniciativa varen nga angazhimi i pronarëve të mediave dhe redaktorëve për gazetari profesionale dhe relevante shoqërore.

## 2.3 Përmirësimi i kapaciteteve dhe përfaqësimit të organizatave profesionale të gazetarëve

Numri më i madh i problemeve me të cilat ndeshen mediat në zonën e zgjerimit buron nga dobësia qytetare e komunitetit të mediave në këto vende. Ato janë kryesisht të fragmentuara dhe të polarizuara politikisht, duke dhënë hapësirë të mjaftueshme për klientelizëm dhe për rënie të standardeve profesionale. Shumë shpesh ndodh që profesionistët e mediave nuk janë të aftë për të kapërcyer ndarjet dhe përkatësitë e tyre politike, për hir të të rënit dakord për interesat e përbashkëta: qofshin ato këmbëngulje për marrëdhënie të duhura të punës, ose për vetë-rregullimin efikas dhe përfaqësues në sektorin e mediave. Pamundësia për të ushtruar solidaritet në kuadër të sektorit dhe për të mbrojtur të drejtat e punës ka krijuar një situatë të autocensurës së përhapur, për shkak të ekspozimit të gazetarëve ndaj eporëve të tyre – pronarve të mediave dhe redaktorëve. Ngjashëm, vetë-rregullimi i mediave, i cili kishte për qëllim ruajtjen e standardeve etike dhe profesionale, nuk mund të përparojë pikërisht për shkak të fragmentimit dhe polarizimit të komunitetit të mediave. Kjo shërben si bazë (dhe ndonjëherë si pretekst) që gjyqësori të ndërhyjë në gazetarinë kritikuese.

Më me rëndësi është ajo se gazetarët duhet vetë të jenë drejtuesit kryesorë të ndryshimit të pritur për sa i përket lirisë së mediave. Zgjidhje për problemet e vazhdueshme duhet të gjenden në nivel nacional, me kusht që të mos jenë të përfshira në ligjet e BE-së, në një dialog me autoritetet nacionale. Në ato pak raste ku organizatat profesionale të gazetarëve në vendet e zgjerimit janë treguar më të fuqishme dhe janë dakorduar mbi një linjë të përbashkët për sa u përket interesave të tyre profesionale, mund të regjistrojmë përparim pozitiv në agjendën e lirisë të shprehjes. Prandaj, Komisioni do të shfrytëzojë përvojën e akumuluar, duke mbështetur zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe organizatat e veta në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, dhe do t'i ndihmojë organizatat e gazetarëve dhe mediave.

## 3. MBËSHTETJA E BE-së

Komisioni do të ofrojë një kombinim të mbështetjes politike dhe financiare për t'i plotësuar këto prioritetet, duke përdorur qasje më strategjike, efektive dhe të fokusuar drejt rezultateve, për të pasur ndikim maksimal me burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare në dispozicion.

Në mbështetjen e vet politike, Komisioni do të inkurajojë vendet e zgjerimit të bëjnë legjislacion që mbështet më shumë mediat. Komisioni gjithashtu do të promovojë përfshirjen e mediave dhe shoqërisë civile në procesin e para-anëtarësimit, duke përfshirë këtu formulimin, implementimin dhe mbikqyrjen e strategjive të sektorit për ndihmë financiare të BE-së, e cila do të forcohet në kuadër të IPA II.

Ndihma financiare e Komisionit do të përdorë një përzierje të duhur të instrumenteve të financimit<sup>6</sup> për t'iu përgjigjur llojeve të ndryshme të nevojave dhe konteksteve të vendit në mënyrë fleksibile, transparente, me kosto efektive dhe e orientuar në rezultate, e cila gjithashtu merr parasysh barrën administrative të Komisionit. Kjo do të përfshijë: synimin për kontrata më afatgjate, pranimin e faktit se ndërtimi i kapaciteteve dhe përkrahja kanë nevojë për kohë dhe burime; largimi nga mbështetja e bazuar në projekte drejt një qasjeje më fleksibile që kultivon ndërtim të partneritetit dhe koalicionit.

Duhet të kuptohet gjithashtu se financimi i BE-së që ka të bëjë me pranimin është i kufizuar në vëllim dhe në kohë. Edhe pse ka qenë donatori më i madh për mediat dhe shoqërinë civile, BE-ja nuk mund dhe nuk duhet të synojë të plotësojë zbrazëtirën e krijuar financiare pas largimit të donatorëve të tjerë nga rajoni. Me lëvizjen e vendeve të zgjerimit drejt aderimit, Komisioni do të mbështesë organizatat mediatike të bëhen më të pavarura nga financimi i donatorëve ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe financimin nga BE-ja.

Udhëzimi duhet të jetë i përdorshëm në mars 2014 dhe do të shërbejë si bazë për mbështetjen e mediave në të dyja nivelet – rajonal (multi-përfitues) dhe vendet e veçanta. Pasi që të hyjë në përdorim, udhëzimi duhet të bëhet pjesë e strategjive IPA të vendit dhe strategjive IPA shumë-vendore dhe do të inspirojë programimin për periudhën 2014-2020. Sapo të ketë përfunduar procesi i konsultimit, do të përgatitet dhe miratohet vendimi i parë i financimit (2014-2015), me veprime të veçanta për të mbështetur lirinë e mediave dhe integritetin e mediave si në nivel të vendit ashtu edhe në nivel shumë-vendor

<sup>6</sup> Komisioni mund të marrë parasysh të gjitha instrumentet e financimit dhe qasjet e planifikuara në Rregullativën Financiare. Këtu përfshihen projekte, financim i programeve, çmime të drejtpërdrejta, financime të grumbulluara, grante shoqërore, thirrje të thjeshtësuara dhe grante të sërishme.

## 4. MATJA E REZULTATEVE DHE NDIKIMIT

Këto udhëzime janë formuluar në formë të kornizës për rezultate të planifikuara. Korniza përmban qëllime dhe rezultate që duhen arritur me anë të hartimit dhe vendosjes së programeve ndihmëse bilaterale dhe shumë-përfituese. Vëmendje e veçantë i është kushtuar aspektit të verifikimit: treguesit e matshëm (dhe standardet) janë të grupuar sipas rezultateve të caktuara që duhen arritur, kurse mjetet e mundshme të verifikimit (MoV) janë identifikuar për çdo grup të treguesve. Përzgjedhja e treguesve dhe MoV gjithashtu merr parasysh koston e efikasitetit dhe dispozicionin aktual të të dhënave.

Mbikqyrja e udhëzimeve do të kontrollohet nga DG ELARG në bashkëpunim me Delegacionet e BE-së në rajon, organizatat ndërkombëtare dhe rrjetet e OShC-ve që janë tashmë aktive në fushën e lirisë dhe integritetit të mediave. Grumbullimi i të dhënave do të përfshijë vlerësime sasiore dhe cilësore dhe do të realizohet me anë të sondazheve, vlerësimeve profesionale, vlerësimeve të pavarura, etj.

Korniza e rezultateve do të mundësojë matjen e progresit në nivel të vendit dhe në gjithë rajonin e zgjerimit. Sistemi i mbikqyrjes dhe vlerësimit do të përfshijë një mbledhje vjetore (ose një herë në dy vjet) rajonale me përfshirje të organizatave mediatike, OShC-ve dhe transmetuesve, për të analizuar gjendjen dhe progresin drejt qëllimeve. Meqë kjo mund të shërbejë si input në raportet vjetore të progresit, pulset politike të Komisionit do të jenë të lidhura me të.

## PROPOZIM KORNIZA E REZULTATEVE

Korniza e rezultateve të propozuara është hartuar në pajtim me parimet dhe synimet e caktuara në Dokumentin vjetor për Strategjinë e Zgjerimit dhe në dokumente të tjera politike të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim, për të mbështetur lirinë dhe integritetin e mediave për periudhën 2014-2020. Kjo është konceptuar si kornizë për rajonin e zgjerimit në tërësi dhe do të ofrojë bazën për një qasje të veçantë në nivel nacional, në pajtim me kontekstin e vendit. Treguesit janë definuar në konsultim me pjesëmarrësit e komunitetit të mediave nga rajoni i zgjerimit dhe me organizatat relevante ndërkombëtare. Një ngjarje e këmbimit të ideve, ku u përfshinë disa nga ato, u mbajt më 7-8 nëntor 2013 në Bruksel. Pas kësaj pasuan konsultime të gjera në internet, më 6 janar 2014. Pikë-referimet dhe treguesit duhet të riakordohen edhe më tej, duke i trajtuar ato nga pikëpamja operacionale/ e lehtë për t'u vlerësuar.

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit <sup>7</sup>
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
<b>1.</b> Mjedisi i favorshëm ligjor, rregullator dhe politik për ushtrimin e të drejtave të lirisë së të shprehurit dhe integriteti i mediave	<b>1.1</b> Parlamentet (dhe qeveritë) në vendet e Zgjerimit: <ul style="list-style-type: none"> <li>realizim i vlerësimeve periodike të gjendjes që ka të bëjë me lirinë e mediave, matja e ligjeve dhe praksave nacionale në bazë të parimeve bazë mbi "cilësinë e ligjit" të caktuar në praksën gjyqësore ECtHR dhe treguesit e radhitur në Rezolutën PA të Këshillit të Evropës 1636 (2008).</li> <li>prezantimi dhe miratimi i politikës dhe propozimeve legjislative në pajtim me ligjin e BE-së dhe me parimet e lartëpërmendura, dhe treguesit për shqyrtimin e mangësive.</li> </ul>	<b>1.1.a</b> Janë realizuar vlerësimet vjetore të legjislacionit ekzistues, aktet e tjera ligjore që ndikojnë mbi mediat dhe faktorët që ndikojnë mbi lirinë e të shprehurit. <b>1.1.b</b> Niveli (p.sh. numri i organizatave, mundësisht, grupet e përbashkëta parlamentare/ gazetareske, komisionet, etj.) me të cilat organizatat profesionale të gazetarëve, OJQ-të e interesuara në media dhe aktorë të tjerë me rëndësi (rregullatorë, organet vetë-rregullatore, ombudsmeni, etj.) konsultohen në mënyrë transparente dhe të involvuara në përgatitjen e vlerësimeve të parlamenteve dhe propozimet në vazhdim. Janë publikuar vlerësimet e pavarura nga institutet hulumtuese, institutet ndërkombëtare dhe ngjashëm (nëse janë në dispozicion) dhe formojnë pjesë të dialogut me parlamentet. <b>1.1.c</b> Numri i propozimeve (p.sh. qasjet politike/ "strategjitë", propozim ligjet) të bëra dhe të realizuara si rezultat i vlerësimit të lartëpërmendur.	Vlerësim i pavarur nga II.00. dhe / ose OShC-të e mediave rajonale.  Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikateve dhe OShC-ve.
	<b>1.2</b> Aktet gjyqësore në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe praksa e zbatueshme gjyqësore. Praksë e rëndësishme gjyqësore nga ECtHR (Neni 10) e përkthyer, e azhurnuar rregullisht dhe e publikuar. Janë hartuar planprogramet nacionale për trajnim gjyqësor dhe janë azhurnuar rregullisht lidhur me standardet e lirisë së mediave. Zyrtarët publikë të përmbahen nga hedhja e akuzave kundër mediave kritikuere ("pragu" i shtuar i "tolerancës").	<b>1.2.a</b> Numri i personelit gjyqësor të trajnuar në zbatimin e praksës gjyqësore ECtHR, mbi lirinë e të shprehurit; trajnimi përfshin edhe zbatimin e legjislacionit që ndikon mediat në pajtim me të drejtat themelore (përfshirë këtu edhe të shprehurit e lirë) <sup>8</sup> <b>1.2.b</b> Numri i vendimeve që kanë të bëjnë me mediat që janë konsekuente me praksën gjyqësore të ECtHR. <b>1.2.c</b> Dinamika në numra të rasteve gjyqësore (raste të lirim, dënimit, shkallët e dëmve të dhëna dhe përpjestimi i sanksioneve të tjera, etj.) ku akuzat shtyhen nga zyrtarë publikë në bazë të kritikave të mediave (shpifja dhe ligjet e tjera).	Raport vjetor nga Gjykatat Supreme dhe Akademitë Gjyqësore, varësisht nga vendi.  Shqyrtimet kolegjiale në Kapitullin 23 dhe 24.

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
	<p><b>1.3</b> Institucionet shtetërore dhe autoritetet publike marrin veprime pozitive për të siguruar dhe promovuar pluralizmin e mediave dhe pavarësinë e tyre. Ushtrimi i ligjit në media (p.sh. ligjet mbi tatimet, punën dhe ligje të ngjashme) nuk lënë përshtypjen e "drejtësisë selektive". Kufizimet e vazhdueshme të informatave, në bazë të privatësisë apo sigurisë nacionale janë proporcionale.</p>	<p><b>1.3.a</b> Numri i deklaratave të zyrtarëve publikë që mund të kenë efekt autocenzurues mbi mediat.</p> <p><b>1.3.b</b> Zvogëlohet numri i sulmeve fizike, kërcënimeve dhe formave të tjera të kanosjes të mediave. Rastet e këtyra trajtohen me ushtrimin e ligjit dhe gjyqësisë në kohë të duhur.</p> <p><b>1.3.c</b> Rregullat për qasje në informata janë në përdorim dhe respektohen nga autoritetet pa vonesa (numër i shtuar i përgjigjeve që përputhen me afatet e përcaktuara; zvogëlim i ankesave lidhur me përgjigjet jo të plota, të vonuara ose të pa pranuar).</p>	<p>Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikatave dhe OShC-ve.</p> <p>Mbikqyrja e raporteve të realizuara nga OShC-të ndërkombëtare dhe / ose rajonale.</p>
	<p><b>1.4</b> Rregullatorët e pavarur dhe profesionalë ruajnë pluralizmin e mediave dhe parandalojnë konkurrencën e padrejtë në tregun mediatik.</p>	<p><b>1.4.a</b> Legjislacioni parasheh funksionim të pavarur dhe profesional të autoriteteve rregullative të sektorit transmetues pa ndërhyrje politike ose ndërhyrje të tjera. Ata punojnë në mënyrë transparente dhe efektive. Rregullatorët (dhe sektori) konsultohen lidhur me ndryshimet e rregullave. Kufizimet qeveritare/legjislatore nga veprime që mund të kualifikohen si ndërhyrje në pavarësinë e rregullatorëve. Sigurimi i autonomisë financiare të rregullatorëve; kjo reflektohet në raportin vjetor nga rregullatori lidhur me realizimin e detyrave kryesore. Është themeluar evidentimi i pavarësisë së rregullatorëve, transparencës dhe profesionalizmit të tyre.</p> <p><b>1.4.b</b> Rregullatorët ofrojnë të dhëna transparente (vjetore), të besueshme (në aspekt të përfituesve kryesorë) dhe të dhëna të hapura mbi pronësinë e mediave. Deklaratat për performancën ekonomike / financiare të mediave janë në dispozicion.</p>	<p>Shqyrtimet kolegjiale në suaza të Kapitullit 10 Shoqëria informative dhe mediumet.</p> <p>Takimet e nënkomiteteve Kapitulli 10.</p> <p>Vlerësimi i pavarur nga II.OO. dhe / ose OShC-të rajonale</p>

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
		<p><b>1.4.c</b> Legjislacioni kundër monopolit të mediave dhe pozitat dominuese në treg tani është themeluar dhe është vënë në përdorim (ndjekja e të dhënave). Gjobat janë proporcionale. Të dhënat e vënies në fuqi janë bërë publike.</p> <p><b>1.4.d</b> "Reklamat shtetërore" dhe çdo përdorim tjetër direkt ose indirekt i parave publike në media, trajtohet në përputhje me qeverisjen e mirë për të garantuar trajtim të drejtë, neutral dhe të barabartë, (janë themeluar rregulla dhe janë zbatuar nga autoriteti konkurues ose krahasues). Vëllimi dhe pjesa e reklamës shtetërore, përdorime të tjera të parave shtetërore sipas mediumit janë të publikuara.</p> <p><b>1.4.e</b> Transparenca në reklamat e dërguara nga kompanitë e mëdha që janë pronë shtetërore. Publikohet vëllimi dhe pjesa e tyre sipas mediumit.</p> <p><b>1.4.f</b> Politikat publike (p.sh. lidhur me digjitalizimin, nisjen e fushatave për publicitet zyrtar) dhe propozimet rregullatore zhvillohen në bazë të analizës së sektorit dhe në bazë të matjes së verifikuar të audiencës (e implementuar në mënyrë të rregullt).</p> <p><b>1.4.g</b> Autoritetet përgjegjëse (p.sh. organet rregullatore) performojnë analizë periodike të sektorit për të zbuluar shtypjen ekonomike jozyrtare mbi raportimin e pavarur (p.sh. me anë të agjencive reklamuese, pronarët e mediave që marrin pjesë në prokurimin publik, pronësitë e tërthorta, etj.). Janë themeluar kontrolle ligjore kundër këtyre presioneve.</p> <p><b>1.4.h</b> Privatizimi i mediave që janë pronë shtetërore është realizuar në mënyrë transparente dhe duke respektuar konkurrencën e drejtë.</p>	

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
	<b>1.5</b> Stimulimi i kërkesës publike për gazetari cilësore. Rritja e qasjes, analizimit, vlerësimit dhe krijimit të mediave dhe kuptimi i rolit të gazetarisë profesionale dhe etike në mediat e rregullta dhe ato në internet.	<p><b>1.5.a</b> Janë themeluar programet publike që promovojnë qasjen, analizimin, vlerësimin dhe krijimin e mediave.</p> <p><b>1.5.b</b> Interneti mbetet i lirë (rregullativa nuk kërkon bllokimin ose filtrimin e përmbajtjes së internetit, provajderët e internetit respektojnë qasjen e lirë në internet si të mirë publike).</p> <p><b>1.5.c</b> Autoritetet publike kanë hartuar strategji për mbështetjen e mediave të "reja"/të internetit, lokale dhe alternative (përfshirë këtu definicionin e përgjegjësisë publike të provajderëve të shërbimit të internetit).</p>	Vlerësim i pavarur nga OShC-të rajonale
	<b>1.6</b> Mediat e Shërbimit Publik – sigurojnë pluralizmin e përmbajtjes në mjedisin mediatik në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme.  Reforma e Transmetuesit të Shërbimit Publik – udhëzuar nga fushëveprimi i Shërbimit Publik dhe ndarja adekuate e buxhetit – është implementuar. Transmetuesit e shërbimit publik mbajnë të dhëna të profesionalizmit, transparencës dhe pavarësisë.  Digjitalizimi i transmetimit i implementuar në mënyrë transparente, i cili siguron pluralizmin e mediave dhe respekton rregullat e konkurrencës.	<p><b>1.6.a</b> Fushëveprimi i Mediave të Shërbimit Publik i definuar në ligj (siç është paraprirë nga konsultime të gjera publike).</p> <p><b>1.6.b</b> Ligji parashikon pavarësi redaktuese dhe është kundër politizimit të Transmetuesve të Shërbimit Publik. Është themeluar përfaqësuesi i bordit këshillues (i shoqërisë në përgjithësi: pakicave, OJQ-ve, akademikëve dhe ngjashëm).</p> <p><b>1.6.c</b> Qëndrueshmëria dhe autonomia e mekanizmit financues të Transmetuesve të Shërbimit Publik; fondet e mjaftueshme për të performuar Shërbimin Publik: shkalla e autonomisë e burimeve financiare (pjesa e BPV-së, pjesa e buxhetit vjetor, format e kuotave të abonimit dhe përqindja e grumbullimit të tyre, etj.), mjaftueshmëria e tyre për të përmbushur fushëveprimin e Shërbimit Publik</p> <p><b>1.6.d</b> Transmetuesit e Shërbimit Publik abonohen në përgjegjësi me anë të publikimit të raporteve vjetore (përfshirë këtu edhe ato financiare) sipas fushëveprimin të Shërbimeve Publike, siç është paraparë me ligj dhe në planet vjetore të punës.</p>	Vlerësim i pavarur nga II.OO. dhe/ose OShC-të rajonale.  Kapitulli 10, mbledhjet e nënkomiteteve (për sa i përket anës ligjore)

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
		<p><b>1.6.e</b> Është themeluar Kodi etik dhe mekanizmi efektiv për të shqyrtuar ankesat e shikuesve.</p> <p><b>1.6.f</b> Matja e dinamikës së besimit publik në Transmetimin e Shërbimit Publik</p>	
	<b>1.7</b> Iniciativë dhe kreativitet nga institucionet shtetërore në përdorimin e mjeteve në dispozicion për promovimin e fjalës së lirë dhe shumëllojshmërinë e mediave	<b>1.7.a</b> Veprime të tjera të ndërmarra nga autoritetet që synojnë lirinë e të shprehurit dhe pluralizmin e mediave.	Të përcaktohet
<b>Avancimi i mediave në një nivel modern të qeverisjes së brendshme</b>			
<b>2.</b> Mediat (pronarët/redaktorët) marrin përgjegjësinë për qeverisje dhe produksion të përmirësuar të brendshëm. Fleksibiliteti më i madh i mediave ndaj shtypjeve të jashtme. Rritja e besueshmërisë së audiencës në media.	<p><b>2.1</b> Mediat u përmbahen në mënyrë vullnetare parimeve të transparencës (siç kërkohet nga një qeverisje e mirë). Janë themeluar shoqata profesionale të pronarëve të mediave/ botuesve.</p> <p><b>2.2</b> Mediat abonohen në mënyrë vullnetare dhe implementojnë standarde adekuate të punës. Marrëdhëniet e punës nuk janë më faktor për autocenzurë (shih edhe 4.5.).</p>	<p><b>2.1.a</b> Numri i mediave që ofrojnë qasje të hapur në të dhënat kryesore lidhur me qeverisjen dhe financat e përbashkëta (p.sh. struktura e pronësisë, të ardhurat e pranuar nga shteti, burimet e financimit, bilancet, pjesa e tregut, etj.).</p> <p><b>2.2.a</b> Numri i shtuar i gazetarëve (përfshirë këtu edhe gazetarët me gjysmë orari dhe ata të pavarur) raportojnë kontrata adekuate të punës me mbrojtje të mjaftueshme sociale.</p> <p><b>2.2.b</b> (Numri i) marrëveshjeve të nënshkruara kolektive. Numri dhe statusi i personelit të pavarur me gjysmë orari të punës.</p> <p><b>2.2.c</b> Gazetarët nuk raportojnë pengesa në lirinë e asociimit [në sindikata]. Kodi i brendshëm i sjelljes e parashikon qartë këtë të drejtë.</p>	Vlerësim i pavarur nga OShC-të rajonale  Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikatave dhe OShC-ve.  Vlerësim i pavarur nga OShC-të ndërkombëtare dhe/ose rajonale.

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
	<b>2.3</b> Vetë-zbatimi i normave etike dhe standardeve profesionale.	<b>2.3.a</b> Numri i mediave me kode të hartuara shtëpiake (p.sh., në pajtim me Federatën Evropiane dhe Ndërkombëtare të Gazetarëve) dhe mekanizmat efikasë që merren me ankesat e lexuesve /shikuesve (p.sh. ombudsman, redaktori i lexuesve). <b>2.3.b</b> Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikatave dhe OShC-ve. Numri i gazetarëve të shkarkuar në bazë të raportimit kritik (në përputhje me kodin redaktues).	Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikatave dhe OShC-ve.
	<b>2.4</b> Strukturat e përforcuara për trajnime fillestare dhe të vazhdueshme dhe edukim i gazetarëve dhe studentëve të gazetarisë lidhur me standardet profesionale, lirinë e të shprehurit dhe integritetin e mediave. Nuk ka kufizime ligjore për profesionin e gazetarisë. Përdorim i procedurave të drejta, transparente të akreditimit, të pavarura politikisht.	<b>2.4.a</b> Numri i planprogrameve të zhvilluara dhe të implementuara për kolekshet/ shkollat e gazetarëve, të cilat përfshijnë kodet dhe standardet etike. <b>2.4.b</b> Numri i shtuar i bursave dhe gazetarët dhe publicistët profesionalë si persona burimorë në programet e trajnimit	Vlerësim i pavarur nga OShC-të rajonale
	<b>2.5</b> Mediat promovojnë trajnimin profesional (përfshirë këtu trajnimin për etikën profesionale).	<b>2.5.a</b> Programet e zhvillimit profesional janë vënë në përdorim; numri mesatar i orëve të trajnimit për të punësuar, definuar sipas politikës për zhvillim të personelit (kategori të ndryshme).	Vlerësim i pavarur nga OShC-të rajonale.
	<b>2.6</b> Investimi në menaxhimin profesional të kompanisë. Performanca e përmirësuar ekonomike e mediumit në tregjet e ndryshueshme	<b>2.6</b> Është duke u implementuar numri/përqindja e mediave me plane të biznesit të definuara mirë	Të përcaktohet
	<b>2.7</b> Rifitimi i besimit të audiencës.	<b>2.7.a</b> Matja sasiore dhe cilësore e vlerësimit të audiencës për mediat që fillojnë me qeverisje të përmirësuar (përfshirë këtu edhe politikën e përmirësuar redaktuese).	Matja e audiencës

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
3. Gazetari hetuese cilësore dhe e besueshme, në dispozicion për qytetarët.	<b>3.1</b> Kushtet e përmirësuar për gazetarinë cilësore hetuese (shih edhe: 1.3.b; 4.5.a; 2.4.b) duke përfshirë këtu edhe qasjet moderne/ inovative për të përmirësuar cilësinë dhe kredibilitetin e gazetarisë hetuese.  Bashkëpunimi i shtuar mes gazetarëve, grupeve të tyre dhe OShC-ve për të përfituar nga gazetaria hetuese.  Programet e trajnimit për qasjet moderne analitike në gazetarinë aktuale hetuese.	<b>3.1.a</b> Numri i projekteve të përbashkëta gazetareske /OShC. Numri i ekipeve bashkëpunuese dhe rajonale që i janë kushtuar gazetarisë hetuese  <b>3.1.b</b> Pjesa e buxhetit të mediave (përfshirë edhe Mediat e Shërbimit Publik, mediat lokale dhe ato në internet) e dedikuar për gazetarinë hetuese. Numri i ("faqeve") të transmetuara lidhur me tregime hetuese.  <b>3.1.c</b> Njohja publike e gazetarisë cilësore hetuese	Të përcaktohet  Të përcaktohet  Matja e audiencës
<b>Rritja e kapaciteteve dhe përfaqësimit të organizatave profesionale të gazetarëve</b>			
<b>4.</b> Organizatat përfaqësuese profesionale të mediave dhe gazetarëve që kanë aftësi të marrin përgjegjësinë e çështjeve të rëndësishme të sektorit në dialog me autoritetet si dhe ofrimi i shërbimeve për anëtarët e tyre.	<b>4.1</b> Dialog i rregullt në kuadër të komunitetit të mediave të themeluar në lirinë e shtypit dhe çështjet e integritetit. Janë formuar platformat e gjera (organizatat profesionale të gazetarëve, OJQ-të, organizatat hulumtuese, redaktorët dhe pronarët).	<b>4.1.a</b> Frekuenca dhe produktiviteti i mbledhjeve të realizuara: numri dhe rëndësia e konkluzave dhe veprimeve të përbashkëta në nivel nacional dhe rajonal.  <b>4.1.b</b> Profesionistët mediatikë dhe opinioni publik tregojnë vetëdijësim lidhur me çështjet e lirisë së të shprehurit.	Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikatave dhe OShC-ve (dhe publikun – TBC).



Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
	<p><b>4.2</b> Organizatat e mediave/shoqatat e gazetarëve veprojnë në bazë të vizionit dhe strategjive afatgjata, për të arritur ndikim. Dialogu produktiv me autoritetet e themeluara</p>	<p><b>4.2</b> Mediat dhe organizatat e gazetarëve angazhohen në dialog të informuar me autoritetet në mënyrë të koordinuar. Respekt më i madh ndaj këtyre organizatave. Reflektohet veçanërisht në:</p> <p><b>4.2.a</b> aftësi e shtuar e grumbullimit të fondeve (për të mbështetur realizimin e planeve afatgjata) dhe vetë-qëndrueshmëri e gjatë financiare</p> <p><b>4.2.b</b> numri i veprimeve përkrahëse të organizuara dhe të implementuara</p> <p><b>4.2.c</b> numri i aktiviteteve të përbashkëta të politikës (p.sh. dialogje me autoritete publike për të sugjeruar ose ndikuar politika apo legjislacion të ri); ndikimi i këtyre veprimeve mbi vendime të miratuara</p> <p><b>4.2.d</b> numri i anëtarëve që kanë përfutur nga ndihma ligjore</p> <p><b>4.2.e</b> gama e shërbimeve në dispozicion për anëtarët</p> <p><b>4.2.f</b> dinamika në numra të anëtarësisë.</p>	<p>Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikatave dhe OShC-ve.</p> <p>Vlerësim i pavarur nga OShC-të rajonale.</p>
	<p><b>4.3</b> Organizatat e mediave mbikqyrin dhe vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e punës së vet.</p>	<p><b>4.3.a</b> Raportet vjetore të organizatave mediatike që mbikqyrin dhe vlerësojnë projektet dhe programet e tyre, me anë të përdorimit të pikënisjeve dhe treguesve të cilësisë. Numri i organizatave të mediave që publikojnë raportet e tyre.</p>	<p>Raportet e organizatave mediatike.</p>

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
	<p><b>4.4</b> Platformat (gazetarë, organizata profesionale, OJQ, pronarë të mediave dhe redaktorë) krijojnë dhe promovojnë në mënyrë aktive standardet profesionale dhe etikën.</p>	<p><b>4.4.a</b> Prezenca e organeve vetërregullatore me përfaqësim të rëndësishëm nga komuniteti i mediave (p.sh. numri i mediave, pjesa e tregut mediatik e mbuluar nga ato), efikasiteti i rregullave të miratuara: numri i vendimeve të marra kundër anëtarëve të tyre dhe përqindja e implementimit të tyre.</p> <p><b>4.4.b</b> Dinamika e kontributeve financiare të komunitetit të mediave, mediave dhe pronarëve të mediave në organin (et) vetërregullator/e (p.sh. Këshilli i Mediave), duke treguar respekt ndaj rregullave të miratuara bashkarisht, qëndrueshmëri institucionale.)</p> <p><b>4.4.c</b> Organi vetërregullator bashkëpron me gjyqësorin dhe është në dispozicion për t'i dhënë këshilla.</p>	<p>Vlerësim i pavarur nga II.00. dhe / ose OShC-të rajonale.</p>
	<p><b>4.5</b> Përpilim i standardeve të punës dhe përmbajtja e tyre.</p>	<p><b>4.5.a</b> Numri i shtuar i gazetarëve që raportojnë kontrata adekuate të punës me mbrojtje të mjaftueshme sociale (shih edhe: 2.2)</p> <p><b>4.5.b</b> Sindikatet e njohura si partnerë në negociatat e marrëveshjeve kolektive. Numri i mediave ku ujdite mes sindikateve dhe punëdhënësve janë realizuar me rezultate pozitive. Cilësia e marrëveshjeve të arritura (përballë sfondit të standardeve të punës).</p>	<p>Sondazh në mesin e mediave, gazetarëve, sindikateve dhe OShC-ve.</p> <p>Vlerësimi i pavarur sipas OShC-ve rajonale.</p>

Synimi	Rezultati	Pikëreferimi/Treguesi	Mjetet e verifikimit
<b>Mjedisi i favorshëm dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë</b>			
		<p><b>4.5.c</b> Numri i aktiviteteve të mbrojtjes dhe lobimit nga shoqatat dhe organizatat e tjera lidhur me standardet e punës.</p> <p><b>4.5.d</b> Cilësia dhe numri i shërbimeve sociale (p.sh. shkalla e mbrojtjes sociale) për gazetarët me gjysmë orari dhe të pavarur</p> <p><b>4.5.e</b> Implementimi i ligjeve nacionale të punës (në media) dhe pasqyrimi i tyre në marrëveshjet e arritura kolektive.</p> <p><b>4.5.f</b> Prezenca (ose mungesa) e pronarëve të mediave/ organizatave punëdhënëse. Roli i tyre në arritjen e standardeve të pranueshme të punës.</p> <p><b>4.5.g</b> (Dinamika në) Numrat e gazetarëve të anëtarësuar në shoqata të gazetarëve.</p> <p><b>4.5.h</b> Përpjekjet për "sindikalizim" (ose "desindikalizim") të mediave.</p>	

7 Kolona "Mjetet e verifikimit" është kryesisht e hapur për momentin. Ajo duhet të reflektojë se në çfarë forme duhet të maten treguesit, për të vërtetuar realizimin e qëllimeve. Duhet vetëm të imagjinoi një spektër të shumëllojshëm të mjeteve dhe aktorëve të involvuar. Për shembull, nëse bëhet fjalë për vlerësimin e cilësisë së ligjeve të miratuara, Komisioni Evropian mund të mbështetet në bashkëpunimin e krijuar Kolona "Mjetet e verifikimit" është kryesisht e hapur për momentin. Ajo duhet të reflektojë se në çfarë forme duhet të maten treguesit, për të vërtetuar realizimin e qëllimeve. Duhet vetëm të imagjinoi një spektër të shumëllojshëm të mjeteve dhe aktorëve të involvuar. Për shembull, nëse bëhet fjalë për vlerësimin e cilësisë së ligjeve të miratuara, Komisioni Evropian mund të mbështetet në bashkëpunimin e krijuar me Këshillin e Evropës dhe OSBE-në. Nëse bëhet fjalë për vlerësimin e ndihmës për organizatat profesionale të gazetarëve me përdorimin e Instrumentit të Shoqërisë Civile, me siguri që do të përdoren mjetet e verifikimit të lidhura me këtë instrument. Nëse ekziston një marrëveshje e përgjithshme në udhëzime, treguesit dhe metodat e verifikimit do të eksplorojnë dhe do të akordohen edhe më tej me organizatat dhe institucionet që kanë përvojë në këtë aspekt (p.sh. mbikqyrja rajonale e OSHC-ve dhe gjendja e mediave).

8 Me anë të shembullit: nëse rasti gjyqësor i referohet për shembull aspekteve fiskale ose ekonomike të një mediumi, gjykata duhet të marrë parasysh rëndësinë publike të mediumit në fjalë për ushtrimin e lirisë të të shprehurit



Bashkimi European